



Network of Open Society for Albania

TRYEZA E RRUMBULLAKET “PROBLEME DHE PROPOZIME MBI LEGJISLACIONIN SHQIPTAR PER ORGANIZATAT JOFITIMPRURESE”

Tirana International Hotel, 6 Prill 2006

Shenimet e takimit

Fjala e hapjes, Z. **Capajev Gjokutaj**, Drejtor i OSFA paraqiti objektivat kryesore te kesaj iniciative:

- 1- Permbushja e boshlleqeve aktuale te ligjit per te lehtesuar punen e sektorit te OJF-ve.
- 2- Mungesa ose pakesimi i burimeve kryesore te financimit nga donatoret e juaj dhe gjetja e alternativave per te zevendesuar ato me burime vendase.
- 3- Ndryshimi i imazhit se OJF-te merren me aktivitet te paligjshem, terrorizem, pastrim parash etj.

Juli Hoxha, drejtoresh e PSh, prezantoi historikun e iniciatives nisor nje vit me pare dhe problemet e sugjerimet e paraqitura ne raport nga grupi i punes.

Ardiana Kalo, juriste, studio ligjore **Kalo@Associate**, prezantoi problemet dhe propozimet e grupit te punes mbi legjislacionin e OJF-ve .

Pyetje dhe sugjerime mbi prezantimin e A.Kalos

Altin Hazizaj, Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve:

- Ndryshimet e propozuara jane procedurale.
- Ne keto ndryshime nuk eshte marre parasysh aspekti i te drejtave te njeriut.
- Ligji kufizon te drejten per t'u organizuar.

- Kërkesa e pasjes se selise është një nga kufizimet e të drejtës, shpesh jepet adresa e shtepisë pasi OJF-te nuk përballojnë dot të kenë një seli.
- Rregjistrimi në Tiranë është një nga kufizimet e tjera të të drejtës për t'u organizuar pasi largësia e madhe nga Tirana mund të bëjë që OJF-te të kenë shumë të vështirë ardhjen.
- Po kështu, një kufizim tjetër është marrëdhënia me bankën.
- Taksat lokale që duhet të paguajnë OJF-te janë shpesh të paperballueshme.
- Cështja e licensimit duhet sqaruar se bëhet fjalë për licensim të aktivitetit të OJF-se dhe jo vetë OJF-se pasi si license për OJF-ne është vendimi i rregjistrimit të saj.
- Emri Jo-fitimprurës është kompromentues pasi vetëm në bazë të bilancit duhen përcaktuar se kush janë fitimprurës e kush jo.
- Në ligj nuk është përcaktuar barazia para ligjit e OJF-ve pasi shpesh qeveria qendrore e vendore ka preferencat e veta në sektor (rasti i Kryqit të Kuq).
- Nuk ka dispozita për mbrojtjen e OJF-ve nga shteti.
- Botimet e raporteve vjetore kanë kosto të paperballueshme nga OJF-te, kemi parasysh këtu organizata që punojnë në baza vullnetare.

Sugjerim: Në takimet e tjera duhet të flitet për të drejtën për t'u organizuar.

Besa Saraci, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

- Duhet të shihet struktura e ligjit për ta bërë atë më të kuptueshëm, të mos ketë dispozita që perseriten, duke mbajtur parasysh tekniken legjislative.
- Decentralizimi i rregjistrimit mund të bëhet por vetëm në rast të një sistemi të informatizuar mirë. Duhet të ketë disa lloj ndryshimesh të cilat mund të rregjistrohen lokalisht dhe disa të tjera në rregjistrin qendror të OJF-ve në Tiranë.
- Problemi i kemi në dy drejtime: ose të mbajmë ligjin që kemi dhe të kërkojmë të zbatohet ose ta ndryshojmë atë.

Juli Hoxha përmendi se grupi është përjekur me Ministrinë e Drejtësisë për të paraqitur ankesat e OJF-ve për decentralizimin e rregjistrimit por rekomandimet nuk janë degjuar.

Profesor Njazi Jaho, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përmendi se për të bërë rekomandime duhet të jemi të përgatitur dhe duhet ta kemi studiuar atë me kujdes. Nënvizoi disa probleme kryesore:

- Është dakort me Z. Gjokutaj për të bërë ligjin sa më ndihmes për sektorin, sidomos për ata që mbijetesën e OJF-ve.
- Ligji duhet përmirësuar në ato çështje që paraqesin vështirësi në praktikë, se në përgjithësi ligji është i mirë.
- Duhet të vihet vëmendje në konfliktin e interesave në vendimmarrje.

- Ligji duhet të mbylle shtigjet për nderhyrje anti-ligjore të shtetit në veprimtarinë e OJF-ve.
- Decentralizimi ka argumenta pro dhe kunder, të merret vendimi i shumicës dhe të shihen anet negative e pozitive të të dyja varianteve.
- Në një nga nënet e ligjit flitet për detyrim në regjistrim por kjo nuk zbatohet.
- Ceshtjet e ligjit kanë gabime në tekniken ligjore në disa nene që lejojnë keqinterpretime, pra duhet parë edhe shtimi i dispozitave të reja, por edhe ndryshimi i atyre që japin keqinterpretime. Përmirësimet të jenë esenciale dhe dytesore.

Fatmir Mema, Forumi Shqiptar Social Ekonomik

- Nuk duhet të diskutojmë në ligj për përcaktime “shoqata me numër të madh” ose me “numër të vogël” pasi numrat janë relative.
- Botimi i raportit vjetor të bëhet vetëm nëse OJF-të kanë të ardhura të mjaftueshme.
- Selia është e domosdoshme por perseri duhet të ketë kritere të vecanta për ato OJF të cilat nuk përballojnë dot një seli të ndryshme dhe në këtë rast të pranohet adresa e shtepisë.
- Duhet të bëhet detyrimi i regjistrimit në zyrën e taksave, pasi sidomos në rrethet OJF-të nuk regjistrohen. Donatorët nuk duhet të mbështesin OJF-të që nuk janë të regjistruara.
- Pjesa e paperdorur e buxhetit të shtetit nuk mund të përdoret për OJF-të pasi edhe teorikisht është e pamundur, në praktike edhe me shumë e pamundur.
- Raportimet për OJF-të duhet të jenë të shkurtra.
- Personat me aftësi të kufizuar duhet të paguajnë taksa e tatime, sepse përndryshe nuk flasim me për barazi e integritet.

Juli Hoxha sqaron se raportet vjetore mund të mos kerkohen detyrimisht të botuara, mund të jenë edhe në formë me të thjeshtë.

Mirjeta Emini, KPMG, prezanton probleme dhe propozime për legjislacionin mbi veprimtarinë financiare të OJF-ve.

Pyetje dhe sugjerime mbi prezantimin e M.Emini

Fatmir Mema, Forumi Shqiptar Social Ekonomik

- Me standartet e reja OJF-ve do të duhet të marrin kontabilist dhe kjo është financiarisht e pamundur për shumë prej tyre. Donatorët nuk paguajnë për kontabilist ose do të paguajnë vetëm për pjesën e tyre.

Dritan Shutina, Co-Plan

- Duhet vendosur prioritetet se çfarë duam të arrijmë.
- Jemi përpara një dileme nëse do të mbajmë standarte të larta dhe të mundohemi që edhe OJF-të e vogla t’i arrijnë ato, ose do të ulim standartet për t’ia pershtatur ato gjithë sektorit.
- Duhet të jemi të kujdesshem për propozimet e bera.

- Raportimi duhet te ekzistojë se tregon transparence.
- Konkurrenca neper tendera, ne rast se behet e ndershme duhet te ekzistojë.
- Nuk duhet te kete standarte te dyfishte per raportimin e aktivitetit ekonomik fitimprures nga aktiviteti ekonomik ne sherbim te publikut. (M.Emini sqaron se behet fjale per raportim te dyfishte dhe jo standart te dyfishte)

Juli Hoxha ve theksin se ne te gjitha mendimet e propozimet duhet te merret parasysh edhe roli i shtetit.

Amalia Tola, Co-Plan

Duhet percaktuar lloji i veprimtarise ekonomike te lejuar per OJF-te, p.sh. baret qe jane hapur nga OJF jane aktivitet i mirefillte fitim-prures. (**Juli Hoxha** sqaron se kjo eshte e rregulluar ne ligj por nuk zbatohet. Organizata mund te percaktoje lidhjen e veprimtarise ekonomike me misionin e saj).

A.Kalo - Kjo pjese e ligjit eshte e mire por problemi qendron me kontrollin nese veprimtaria ekonomike po perdoret ne sherbim te publikut.

Juli Hoxha – permend se ka ligje te tjera qe mund ta rregullojne nje gje te tille por qe jane te mangeta, p.sh. ligji per sponsorizimet.

A. Tola - Raportimi i ndryshem kerkon nje sistem financiar te pershtatur.

M.Emini – Nuk behet fjale per raportim te ndryshem por per raportim te ndare. Pra standarti eshte i njejte por format e raportimit ndryshojne nga njera-tjetra.

Arjana Fullani,

- Tematika e takimit eshte shume e rendesishme por eshte delikate.
- Persa i perket veprimtarise ekonomike te OJF-ve, duhet patjeter qe te goditet ajo veprimtari qe eshte e paligjshme por me kujdes per te mos cenuar ato veprimtari te tjera te ligjshme. Ne rast se do te behet nje dispozite ligjore per kete qellim, ateherë do te kishte nje standart per te gjitha OJF-te dhe mund te prekeshin edhe ato organizata aktiviteti ekonomik i te cilave eshte i mirefillte ne sherbim te publikut. (**Juli Hoxha** sqaron se rregullimi i ceshtjes se veprimtarise ekonomike nuk eshte per te ushtruar nje kontroll me te madh mbi OJF-te por per te rregulluar me ligj procedurat qe OJF-ve te mos u duhet te paguajne rryshfete per te kryer detyrimet me zyren e taksave e tatimeve.)
- Duhet te punohet per nje manual qe te permbaje te gjitha format, procedurat, standartet (taksore e ligjore) qe duhet te ndjehet nje OJF. Shume OJF nuk kane burimet njerezore per te

bere nje gje te tille dhe praktika ka treguar qe OJF shume te njohura e me emer u kane munguar elemente baze te organizimit.

- Ka nje problem me situaten e propozimeve dhe sugjerimeve qe vijne nga ekspertet shqiptare. Ato nuk preferohen dhe nuk degjohen. Ne nje proces te tille propozimesh per ndryshime ligjore eshte mire qe te perfshihen organizata te medha si p.sh. Banka Boterore, qe ne fillim te iniciatives. (**Juli Hoxha** sqaron se Banka Boterore e ka bere nje gje te tille me pare dhe mirepret iniciativa te ketij lloji.)

A.Kalo – Duhet te iniciohet nje fushate e madhe ndergjegjesimi per te treguar arritjet e sektorit te OJF-ve ne vite, per te ndryshuar opinionet negative se OJF-te “hane para”.

Mirela Arqimandriti– Qendra e Aleances Gjimore per Zhvillim

- Te caktohet ne ligj nje strukture e ndermjetme midis OJF-ve dhe shtetit, ku OJF-te mund te drejtohen per te paraqitur propozime, ankime etj dhe me pas kjo strukture t’i drejtoje ata ne institucionin shteteror perkates per te gjetur zgjidhje te problemit.
- Raporti vjetor eshte mire te publikohet.
- Auditimi eshte i rendesishem dhe duhet te behet.